



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C. nr. 997/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore, sipas padisë së paditësit I. K., nga fshati M., Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson N. E., avokat nga Prizreni, kundër të paditurve Sh. K., M. K.1, F. K., M. K.2 dhe B. K., të gjithë nga Prizreni, Rr..., nr..., të cilët me autorizim i përfaqëson e paditura M. K.1, nga Prizreni, për vërtetimi të pronësisë, në seancën publike të shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datën 12 Janar 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

- I. Miratohet në tersi kërkesëpadia e paditësit I. K., nga fshati M., Komuna e Prizrenit.
- II. Vërtetohet se paditësi I. K., nga fshati M., Komuna e Prizrenit, është pronar i njësisë kadastrale nr. 1949-6 ZK L., në sipërfaqe 244 m² e cila evidentohet si oborr dhe sipërfaqe 125 m² e cila evidentohet si shtëpi. Ashtu që detyrohen të paditurit: Sh. K., M. K.1, F. K., M. K.2 dhe B. K., të gjithë nga Prizreni, të pranoj këtë dhe të lejoj regjistrimin në librat kadastrale.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në padi dhe gjatë seancave përmes të autorizuarit të vet, paraqet se diku para 20 vitesh, nga paraardhësi i të paditurve, tani i ndjeri S. K., ka blerë ngastrën kadastrale nr. 1949/6 Zk L.. Për këtë shitblerje kanë pasur marveshje gojore me paraardhësin e të paditurve. Propozon që të mirtatohet kërkesëpadia si e bazuar. Nuk i kërkon shpenzimet e procedurës.

Të paditurit përmes të autorizuarës së tyre deklarohen se nuk e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë. Sqarojnë se paditësi në tersi ka paguar të hollat për ngastrën kontestuese. I propozojnë gjykatës të miraton padinë dhe kërkesëpadinë. Nuk i kërkojnë shpenzimet e procedurës.

Përkundër faktit se pala e paditur nuk ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse, gjykata ka marr provën përmes ekspertizës së gjeodezisë nga ka vërtetuar

se njësia kadastrale kontestuese, evidentohet në emër të S. K., paraardhësi i të paditurve, e njëjta ka sipërfaqen e përgjithshme 369 m², ku 244 m² është oborr, ndërsa 125 m² është sipërfaqja në të cilën është ndërtuar shtëpia.

Pas paraqitjes së ekspertizës nga ana e ekspertit gjeodet, i autorizuari i paditësit bënë përmirësimin e nr. të ngastrës ashtu që kërkon që të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrave kadastrale nr. 1946-6 ZK Prizren dhe 1949-6-16-0 ZK Prizren.

Pasi që pala e paditur në tersi pohoi theksimet e padisë dhe nuk e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, si dhe disponimet e palëve të cilat nuk janë në kundërshtim me nenin 3 par. 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 148 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të miraton si të bazuar kërkesëpadinë e palës paditëse.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, pasi që palët nuk i kanë kërkuar në mënyrë të specifikuar shpenzimet e procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 997/2015 datë 12 Janar 2018

Gjyqtari,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, pemës kësaj gjykate, brenda 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore.